

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË PËRMET

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Bashkinë Përmet, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 01.09.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 18, datë 29.02.2016

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 997/9 datë 29.02.2016, i ka rekomanduar z. Niko Shupuli, Kryetar i Bashkisë Përmet, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet nuk ka ndjekur hapat e nevojshëm ligjor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, me shkresën nr. 990/8, datë 30.12.2012.

Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve ka sjellë për pasojë mos zbatimin e 7 masave me karakter shpërblim dëmi. Vlera e kërkuar nga KLSH për kthimin në buxhetin e njësisë vendore është e kontabilizuar në shumën prej 8,888,886 lekë, por deri në momentin e auditimit në subjekt nuk rezulton të jetë ndërmarrë asnjë veprim tjetër për kërkimin e shumës.

Rekomandim: Bashkia Përmet të nxjerr aktet administrative dhe të kërkoj në rrugë ligjore arkëtimi i shumës prej 8,888,886 lekë në zbatim të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodin e Procedurave Civile” i ndryshuar.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përmet, nuk ka gjetur plotësisht zbatim ligji nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi: nuk kishin dalë aktet administrative për caktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, nuk ishin hartuar dhe miratuar sistemet e menaxhimit të informacionit, si edhe nuk janë ndjekur dhe nuk ka raportime tek titullari i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave të njësisë vendore.

Rekomandimi: Bashkia Përmet, të ngrejë dhe miratojë një sistem për komunikimin dhe përcjelljen e informacionit, ndërmjet sektorëve dhe eprorëve, si pjesë e llogaridhënies, bashkëpunimit dhe e kontrollit të brendshëm, duke vendosur një sistem efikas të kontrollit të brendshëm në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Përmet, mungojnë programe të plota financiare afatmesme (PBA) në kundërshtim me UMF nr. 20/1, datë 26.02.2011, nr. 7/1, datë 29.02.2012 dhe nr. 9/1 datë 25.02.2013 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”. Programet buxhetore vjetore janë paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak thjesht duke përshkruar të dhënat tabelore, pa një analizë të hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë, me një planifikim të pastudiuar dhe të fryrë pa bazë reale të të ardhurave

dhe shpenzimeve, duke e kthyer buxhetin e vitit koherent në buxhet inkoherent, që pjesën e më të madhe financon borxhet e trashëguara të viteve të mëparshme.

Gjithashtu mungojnë raportet periodike të monitorimit të buxhetit të paraqitura pranë Këshillit Bashkiak si dhe analiza faktoriale e treguesve të realizimit të ardhurave dhe shpenzimeve UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit të zhvillimit ekonomik afatmesëm dhe atij vjetor të mirë studiuar, hartimin dhe planifikimin e treguesve, të bazuar mbi hartimin më parë të planit strategjik të zhvillimit, ku të jenë përcaktuar objektiva të qarta, fushat prioritare, projektet, i detajuar në programe mujore si dhe të ndjekë e të monitorojë realizimin e tij, duke bërë analizën faktoriale dhe rekomandimin e masave për përmirësimin e gjendjes.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Janë rekrutuar dhe kanë funksionuar në strukturën e miratuar punonjës, niveli arsimor i të cilëve nuk përputhet me kërkesat e nivelit të funksionit, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikim e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” dhe me VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, lidhja nr. 2, “Përshkrim i përgjithshëm i punës për çdo kategori dhe klasë”, “Klasa III/2”, “Kërkesa të posaçme” ku përcaktohet se kriteri arsimor për këtë klasë është vetëm diplomë e nivelit të parë (master shkencor).

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat që në rekrutimin dhe emërimin e punonjësve në funksionet e përcaktuara në strukturë, të përcaktohen kriteret në lidhje me nivelin arsimor të përshtatur me kërkesat e pozicionit të punës, gjë e cila ndikon në kryerjen me cilësi të detyrës dhe në realizimin si duhet të objektivave.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III pika 30.

Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës të krijohet dhe të mbahet regjistri i aktiveve, i cili të hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimi, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe

pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në mbylljen e ditareve artikujt kontabël nuk janë hedhur në sistemin centralizator, apo në librin e madh në të cilën duhet të ishin pasqyruar efektet e veprimeve ekonomike të klasifikuara sipas llogarive të prekura nga azhurnimi në ditarë nëpërmjet mbartjes së shumave nga ditarët në fund të periudhës ushtrimore, procedurë kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës të merren masa që gjatë kontabilizimit dhe hartimit të bilancit të ndiqen hapat e duhura kontabël për veprimet ekonomike të ndodhura, që nga azhurnimi në ditar, kuadrimi i shumave në mënyrë periodike dhe në fund të periudhës ushtrimore, prerja e artikujve kontabël, mbartja e shumave në sistemin centralizator ose në librin mastro, nxjerrja e gjendjeve të llogarive përkatëse të prekura nga veprimet ekonomike, hartimin e bilancit vërtetues deri në hartimin e bilancit përfundimtar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për Aparatin e Bashkisë për 6- mujorin e dytë të vitit 2013 për 37 procedura në shumën 1,261,639 lekë, për vitin 2014 për 44 procedura në shumën 1,458,100 lekë dhe për 8-mujorin e parë të vitit 2015 për 32 procedura në shumën 1,691,035 lekë. Po kështu për Drejtorinë e Ambientit janë kryer pagesa për 6- mujorin e dytë të vitit 2013 për 5 procedura në shumën 407,735 lekë, për vitin 2014 për 48 procedura në shumën 2,090,624 lekë dhe për 8-mujorin e parë të vitit 2015 për 20 procedura në shumën 904,920 lekë.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit të kryera për blerjet me vlera të vogla rezultoi se në këto raste u paraqitën mangësi dhe parregullsi në plotësimin e dokumenteve pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: kërkesat për blerje nuk janë të argumentuara, nuk ka argumentim të fondit limit nëpërmjet pasqyrimit të tre ofertave, akti i marrjes në dorëzim i shërbimeve dhe i mallrave është bërë formal.

E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu II “Rregulla të përgjithshme të Prokurimit” pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës” nën-pika (c) Kreu i VI, pikës 2/a dhe VKM nr 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40/3 “Procedura e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla” dhe neni 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” dhe Udhëzimeve të APP në zbatim të tyre, me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57, datë 12.6.2014 “Për Gjurmën standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 37 dhe rubrika “Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara” pika 42,43 dhe 44.

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masa për hartimin e gjurmës standarde të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, ku të përcaktohet procesi i punës, që nga hartimi i kërkesave deri në përfundimin e procedurës së prokurimit mbi bazën e

dokumenteve financiare justifikues, autorizues dhe vërtetues, duke vendosur strukturat zbatuese dhe të miratohet nga Titullari.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se për vitet 2013 dhe 2014, janë 37 subjekte të pa regjistruara në QKR në kundërshtim me nenin 41, pika 1 e ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, përse i përket ushtrimit të aktivitet brenda territorit të Bashkisë Përmet pa kryer regjistrimin dhe procedurat tatimore nga ana e këtyre subjekteve. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 7, faqe 65-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi: Bashkia, të marrë masa për regjistrimin e subjekteve dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për subjektet që kanë ushtruar aktivitet të pa regjistruar në QKR.

Brenda muajit mars 2016

9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 rezultojnë debitorë 175 familje për mos shlyerjen e taksave për vlerën 1,750,000 lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 156 familje në vlerën 786,360 lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 161 familje, për vlerën 1, 980,500 lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 160 familje në vlerën 555 250 lekë.

Ndërsa për vitin 2014 rezultojnë debitorë 89 familje për mos shlyerjen e taksave për vlerën 2,726,705 lekë. Për taksën e ndërtesës janë debitorë 77 familje në vlerën 762,560 lekë. Për taksën e pastrimit janë debitorë 89 familje, për vlerën 781,900 lekë dhe për tarifën e ndriçimit janë debitorë 89 familje në vlerën 302,085 lekë.

Rekomandimi: Nga ana e Zyrës së Taksave në Bashkinë Përmet, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa likuiduara deri më datën 31.12.2014 për të 3 llojet e taksave të popullatës në vlerën 4,476,705 lekë.

Brenda muajit qershor 2016

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet nuk ka iniciuar procesin e hartimit dhe miratimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit (Plani i Përgjithshëm Vendor), duke mos vepruar e përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara nga neni 20 i ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa dhe të filloj procesin e hartimit dhe miratimit të Instrumentit Vendor të Planifikimit (PPV), duke përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara nga neni 20 i ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë Përmet nuk ka ngritur Këshillin Teknik, i cili duhet të përbëhet me specialist të fushës së planifikimit të territorit, përfaqësues të enteve dhe të ndërmarrjeve të varësisë, dhe ti sugjerojë Kryetarit të Bashkisë, vlerësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për kërkesat për leje zhvillimore ndërtimi për subjekte private dhe publike, veprim në mospërputhje me pikën 3 neni 10, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” të ndryshuar dhe neni 45, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të territorit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa, të ngrejë Këshillin Teknik të përbërë nga specialist të fushës së planifikimit të territorit, përfaqësues të enteve dhe të ndërmarrjeve të varësisë.

Brenda muajit mars 2016

12. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ambientit në Bashkinë Përmet, për vitin 2013-2015, nuk ka hapur dhe nuk ka hedhur në portalin Ueb të sistemit GIS, të dhënat për leje zhvillimore ndërtimi të miratuara për subjektet private dhe publike, veprim në mospërputhje me shkronjën “b” nenin 55, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 459, datë 16.6.2010 “Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”

Rekomandimi: Drejtoria e Ambientit në Bashkinë Përmet të marrë masa, të hedh në portalin Ueb të sistemit GIS, të dhënat për lejet zhvillimore ndërtimi të miratuara për subjektet private dhe publike.

Brenda muajit mars 2016

13. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ambientit, për vitin 2013-2015, nuk ka dërguar në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, projektet e plota të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, dhe në version elektronik, veprim në mospërputhje me nenin 70/12, të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

Rekomandimi: Drejtoria e Ambientit të marrë masa, të dërgojë në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, projektet e plota të çdo zhvillimi të miratuar, së bashku me lejen zhvillimore të ndërtimit, dhe në versionin elektronik.

Brenda muajit mars 2016

14. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ambientit, nuk ka kryer vëzhgime për zhvillimet në territor, për studimin, vlerësimin, parashikimin e rreziqeve dhe të tendencave, për parandalimin e zhvillimeve të dëmshme, për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit, si dhe nuk janë dërguar në Agjencinë Kombëtar të Planifikimit të Territorit, raportet vjetore në lidhje me çështjet administrative të territorit, si dhe nuk ka dërguar informacione dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokës, veprim në mospërputhje me pikën 1, 3, 4 neni 80, të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

Rekomandimi: Drejtoria e Ambientit të marrë masa, të kryej vëzhgime për zhvillimet në territor, studimin, vlerësimin, parashikimin e rreziqeve dhe të tendencave, parandalimin e zhvillimeve të dëmshme, sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit, si dhe të dërgojë në Agjencinë Kombëtar të Planifikimit të Territorit raportet vjetore në lidhje me çështjet administrative të territorit dhe informacione dhe të dhëna në lidhje me zhvillimi e tokë.

Brenda muajit mars 2016 e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Bashkisë në 5 raste, ka bërë miratimin e strukturës ndërtimore për objekte private, pa miratuar më parë Planin e Përgjithshëm Vendor, veprim në mospërputhje me neni 3, 4 të ligjit nr. 110, datë 01.04.2013 “Për disa ndryshime të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa dhe të rishqyrtoj ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e 5 lejeve zhvillimore të miratuara më parë në përmbushje të kriterëve dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Përmet nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Përmet, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për

inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Përmet, në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2001.

Brenda muajit Qershor 2016

17. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Përmet.

Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Rekomandimi: Bashkia Përmet, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Përmet në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira.

Brenda muajit Qershor 2016

18. Gjetje nga auditimi: Për tre raste të dhënies me qira të aseteve publike administrohet vetëm kontrata e lidhur mes Kryetarit të Bashkisë dhe të tretëve, dhe nuk administrohet asnjë dokument tjetër mbi procedurën e ndjekur nga NJQV dhe dokumentacionin e qiramarrësit, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 dhe Kreun II pikat 1/a, b, ç, d, dh, pika 5, 6, 7 të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masa në rrugë administrative dhe ligjore për anulimin e 3 kontratave të qirasë të lidhura në kundërshtim me kriteret dhe detyrimet e përcaktuara në VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Emërimet e punonjësve në strukturën e IMTV (ish-INUV) janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar, pasi Inspektorët nuk kanë arsimin e kërkuar në ligj.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet, të marrë masa dhe të riorganizoj strukturën e IMTV-së në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Përzgjedhja e punonjësve të Policisë Bashkiake në 3 raste është bërë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës” i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake e të Komunës të miratuar me

Urdhrin e përbashkët nr. 1 datë 17.04.2003, të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet, të marrë masa dhe të riorganizoj strukturën e Policisë Bashkiake në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 dhe Rregulloren e Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake e të Komunës të miratuar me Urdhrin e përbashkët nr. 1 datë 17.04.2003.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit **në vlerën prej 11,026,618 lekë si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Anëtarët e KVO në prokurimin publik me objekt “*Rikonstruksioni i trotuareve në bllokun e qendrës*”, kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore në vlerën 7,056,994 lekë, për skualifikimin në kundërshtim me nenet 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim me devijime të vogla të pranura nga ligji dhe duke përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave.

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 7,056,994 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit në ngarkim të V.P., J.P. dhe D.D. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Brenda vitit 2016

2. Gjetje nga auditimi: Nga struktura e IMT-së, për 4 vendime pezullimi të marra për ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, nuk është marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën 400,000 lekë, në kundërshtim me pikën 8 të nenit 82 ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit” dhe gjurmës b të nenit 5 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

Rekomandim: Bashkia Përmet dhe IMT të marrin masa për arkëtimin e shumës prej **400,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi Procedurës Civile” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre, për rastet:

Nr	SUBJEKTI	KOSTATIMI	PEZULLIMI	GJOBE	PRISHJE	EKZEKUTIM
.						

1.	E...l sh.p.k	Nr. 72, 12.07.13	Nr. 37, 12.07.13	-	Nr. 7,31.10.13	-
2.	L.G.	Nr. 85, 04.06.14	Nr. 40, 04.06.14	-	-	-
3.	A.B.	Nr. 89, 28.07.15	Nr. 41, 28.07.15	-	-	-
4.	R...a sh.p.k	Nr. 90, 08.10.15	Nr. 20, 08.10.15	-	-	-

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga struktura e IMT-së, për 6 vendime për prishje që ka marrë për ndërtime në kundërshtime me ligjin nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit” i ndryshuar, nuk është marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën 600,000 lekë në kundërshtim me pikën 8 të VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Përmet dhe IMT të marrin masa për arkëtimin e shumës **600,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi Procedurës Civile” i ndryshuar dhe ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit” i ndryshuar, për rastet:

Nr .	SUBJEKTI	KOSTATIMI	PEZULLIMI	GJOBE	PRISHJE	EKZEKUTIM
1.	E...l sh.p.k	Nr. 72, 12.07.13	Nr. 37, 12.07.13	-	Nr. 7, 31.10.13	-
2.	Y.B.	Nr. 73, 25.07.13	Nr. 38, 25.07.13	-	Nr. 8, 12.11.13	04.12.2013
3.	I.M.	Nr. 77, 03.03.14	-	-	Nr. 13, 15.08.14	26.08.2014
4.	G.J.M.	Nr. 79, 04.03.14	-	-	Nr. 15, 30.01.15	05.10.2015
5.	D.H.N.	Nr. 86, 11.08.14	-	-	Nr. 13, 15.08.14	26.08.2014
6.	D.T.	Nr. 88, 26.01.15	-	-	Nr. 15, 30.01.15	05.10.2015

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet si Autoritet Kontraktor ka lejuar rritjen fiktive të fondit limit për ndërtimin e objektit “*Rikonstruksion i trotuareve në bllokun e qendrës Përmet*”, i cili është rritur më tepër në vlerën **198,623 lekë** pa TVSh, nga devijimi nga çmimet e manualit teknik për 2 zëra punimi, në kundërshtim me germenat “c” e “ç”, pika 2, kreu II, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me Udhëzimin Nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për Disa ndryshime të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001”.

Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **198,623 lekë**, ndaj z. A.P. në cilësinë e Projektuesit dhe z. Gilberto Jaçe në cilësinë e ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Brenda datës 31.03. 2016

5. Gjetje nga auditimi: Në një rast kontrata e lidhur me subjektin “A...S” sh.p.k më datë 01.06.2015, është lidhur pa vlerë monetare, por në shkëmbim të truallit të dhënë me qira “A...S” TV do të transmetoj pa pagesë njoftimet që do të bëjë Bashkia Përmet. Kjo mënyrë për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, e njohur në fushën e biznesit privat si “klering”, është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, pasi ky akt ligjor nuk e parashikon këtë mënyrë bashkëpunimi në dhënien me qira të aseteve publike.

Rekomandim: Bashkia Përmet, të marr masa për arkëtimin e detyrimit ekonomik 63,000 lekë për periudhën qershor-dhjetor 2015 për subjektin “A...S” sh.p.k në zbatim të Kreut III të VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për detyrime të Bashkisë ndaj trajnerëve të ekipit të futbollit në vitin 2013 në shumën 178,200 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 353,800 lekë, detyrime të viteve 2012 dhe 2013 të panjohura pasi ky zë shpenzimesh nuk ka qenë e parashikuar në vitet përkatëse, dhe si të tilla në vitin 2014 në planifikimin e zërit 602 “shpenzime të tjera” nuk janë specifikuar për njohjen e këtyre detyrimeve të prapambetura të palikujduara të viteve 2012-2013 në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, me **pasojë dëmin ekonomik në shumën 542,800 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **542,800 lekë** përkatësisht nga B.H. në shumën 144,400 lekë, nga L.M. në shumën 51,990 lekë, nga K.S. në shumën 199,200 lekë dhe E.K. në shumën 199,200 lekë.

Brenda datës 31.03. 2016

7. Gjetje nga auditimi: Janë bërë pagesa në shumën 55,918,413 lekë operatorit ekonomik fitues “H...I Konstruksion” shpk, duke zbritur 5% e garancisë së punimeve në shumën 2,943,074 lekë për realizimin e investimit të prokuruar me objekt “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Nonda Bulka” në bazë të kontratës nr. 25 të datës 11.01.2012 dhe situacionit përfundimtar në vlerën 58,861,488 lekë (49,051,373 lekë + 9,810,275 (20% TVSH). Në situacionin përfundimtar të punimeve ka zëra shpenzimesh që janë pajisje e materiale ndihmëse të cilat nuk janë zhveshur nga 20% i TVSH në kundërshtim me UKM nr. 2 datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se: *“Shpenzimet për materialet” janë shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore e ndihmëse, të konstruksioneve e prodhimeve të ndryshme, të llogaritura për çdo zë pune, sipas kushteve teknike dhe të standardeve, me çmimet baze, pa tatim mbi vlerën e shtuar (tvsh)”*, me **pasojë dëmin ekonomik në shumën 1,190,500 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **1,190,500 lekë nga firma** “H...I Konstruksion” shpk, përfituar padrejtësisht nga përlllogaritja dy herë e TVSH mbi zërat e situacionuar për makineri e pajisje, të cilat duhet të zbriteshin nga shuma e shpenzimeve të situacionit para se të aplikohet TVSH.

Brenda datës 31.03. 2016

8. Gjetje nga auditimi: Me urdhër-shpenzimin nr.242 datë 05.07.2015 është bërë pagesë në shumën 240,000 lekë operatorit ekonomik fitues “V.M.” në bazë të faturës nr. 45, datë 30.06.2015 për shërbimin “Trajtim ushqimor drekë për 100 persona” në kuadrin e projektit kulturor “Organizimi i Konkursit Poetik “Në gjurmët Naimiane”. Sipas procedurës së prokurimit në sistemin elektronik janë paraqitur 4 oferta oferta, ku tre nga këto janë skualifikuar me të drejtë nga KPVV, pasi nuk plotësonin kriteret e kualifikimit. Edhe OE fitues nuk i plotëson kriteret pasi sipas QKR ka si aktivitet bar-

kafe dhe jo restorant. Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se ky aktivitet nuk është realizuar sipas projektit dhe mungon dokumentacioni i realizimit të tij, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4 pika 26 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 35,36, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 240,000 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat që të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës 240,000 lekë në mënyrë solidare nga hartuesi dhe miratuesi i projektit përkatësisht nga z. G.J. **në shumën 120,000 lekë** dhe z.B.P. **në shumën 120,000 lekë**, për pagesë të kryer në mungesë të dokumentacionit të plotë financiar.

Brenda datës 31.03. 2016

9. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa OE fitues i prokurimit “A.Z.”, për punime “Sistemim i fushës së mbeturinave tek Guri i Atos (GATOS)” përkatësisht me urdhshp nr.39, datë 19.03.2015 në vlerën 99,600 lekë dhe me urdhshp nr. 107, datë 05.07.2015 në vlerën 170,666 lekë. Në bazë të ekstraktit të QKR të datës 18.02.2015 për këtë operator ky shërbim është jashtë fushës së veprimtarisë. Gjithashtu ky operator nuk plotëson dhe kriterin e vendosur në ftesën për ofertë : “*Paraqitjen e aktit të marrjes në pronësi ose me qira të mjetit eskavator, lejen e qarkullimit, figuracionin e vlefshëm*”, pasi ka paraqitur vetëm një deklaratë e panoterizuar nga A.M.S. si pronar i mjetit APV Model CATERPILAR me Targë TR4378J të cilën pretendohet se ka përdorur për kryerjen e punimeve. Nuk ka skicë e plan-vendosje mbi të cilën është hartuar preventiv paraprak. Fatura e paraqitur nuk është shoqëruar nga situacioni i punimeve të kryera. Nga AK nuk është bërë procesverbali i marrjes në dorëzim të punimeve të kryera. Mosparaqitja nga OE i situacionit si dhe mosmarrja në dorëzim e punimeve nga AK me komision me specialistë të fushës nuk vërteton se punimet janë kryer, procedurë kjo në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 34,35,36 dhe me **pasojë dëmin ekonomik në shumën 270,266 lekë.**

Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **270,266 lekë** nga firma “A.Z.” për mungesë dokumentacioni që vërtetojnë se punimet janë kryer.

Brenda datës 31.03. 2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “*Llojet e masave disiplinore*” dhe 59 “*Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përmet:

Të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e trajtuara për secilin punonjës në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga Shërbimi Civil*” për:

1. **z. Ë.N.** me detyrë specialist shërbimesh,
2. **zj. D.D.** me detyrë specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV,
3. **z. D.M.** me detyrë inspektor taksash dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV

4. zj. M.F. me detyrë juriste në zyrën juridike dhe në cilësinë e anëtarit të KPVV|:

- Për mangësitë e konstatuara në plotësimin e dokumenteve pjesë të dosjes së procedurave të blerjeve me vlera të vogla si: kërkesat për përcaktimin e nevojave për blerje, të cilat nuk janë menaxhuar dhe bërë nga Sektori i Shërbimeve në mënyrë të argumentuar, nuk ka argumentim të fondit limit nëpërmjet testimi të tregut nga shqyrtimi i ofertave të grumbulluara të cilat duhet të evidentoheshin në kërkesën për ofertë, mungon dokumenti i raportit të kualifikimit final të miratuar nga Kryetari i AK, akti i marrjes në dorëzim i shërbimeve dhe i mallrave është bërë formal në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pikës 2/a Kreu i VI, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Udhëzimet e APP nr. 2. datë 28.03.2013 dhe nr. 3 datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me UMF nr. 33 datë 11.07.2013 dhe nr. 57 datë 12.6.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011”, pika 37.

- Për mos inicim të hapave ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Përmet, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

5. zj. I.SH. me detyrë Drejtore e Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues.

-Për mangësitë e parregullsitë e konstatuara në dokumentacionin e paraqitur lidhur me shpenzimin e kryer për aktivitetin Konkursi Poetik “Në gjurmët Naimiane” i cili nuk vërteton realizimin e projektit kulturor në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 35,36., **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 240,000 lekë**

-Për mungesë të situacionit të punimeve nga OE si dhe mosmarrjen në dorëzim e punimeve nga AK në lidhje me shpenzimet e kryera për prokurimin me vlera të vogla me objekt: “Sistemin i fushës së mbeturinave tek Guri i Atos (GATOS)” ,duke mos vërtetuar punimet e kryera në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 34,35,36 dhe me **pasojë dëmin ekonomik në shumën 270,266 lekë.**

6. z. K.V. me detyrë Kryeinspektor i IKMT-së, për:

-Për 4 vendime pezullimi që ka marrë për ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi nuk ka marrë asnjë masë dënimi me gjobë, duke krijuar të ardhura të munguara në shumën 400,000 lekë, në kundërshtim me pikën 8 të nenit 82 ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit” dhe gërmës b të nenit 5 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

- Për 6 vendime për prishje që ka marrë për ndërtime në kundërshtime me ligjin nr. 10119 datë 23.04.2009 për “Planifikimin e Territorit”, nuk ka marrë asnjë masë dënimi me gjobë, ka krijuar të ardhura të munguara në shumën 600,000 lekë në kundërshtim me pikën 8 të VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar.

D. 1 MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 7 pika 2, 3/a ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Kreu X i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar:

1.1 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, *konkretisht*:

1. zj. M.F. në cilësinë e juristes,

2. z. Ë.N. në cilësinë e anëtarit,

3. z. I.Sh. në cilësinë e anëtarit.

a. Për prokurimin publik me objekt “Rikonstruksi i trotuareve në bllokun e qëndrës”:

- Nuk ka azhornuar kriteret e vendosura në DST, pasi në nëndarjen për “kapacitetet financiare dhe ekonomike” nuk ka vendosur kriterin për të paraqitur nga ofertuesit një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 11.06.2014 “Për disa shtesa në VKM nr. 1, datë 10.01.2007”.

b. Për prokurimin publik me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin Egjiptian, Përmet”:

- Kriteri i veçantë 2.5/a/b i vendosur nga AK në DST është një kriter diskriminues, jo në pajtueshmëri me ligjin për shkak se AK nuk mund të kërkojë vërtetimi për numrin e punonjësve nga administrata tatimore për një periudhë deri të muajit paraardhës të datës së prokurimit, si në këtë rast kur prokurimi zhvillohet në shkurt 2015 AK kërkon OE vërtetim deri në janar 2015. AK për të ruajtur standardet, barazinë dhe paanshmërinë për një kriter të tillë duhet ta kërkojë deri në 3 muaj paraardhës në respektim të nenit 20 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

1.2 Të shqyrtoj dhe të marrë masa disiplinore ndaj anëtarëve të Komisioni Vlerësimit të Ofertave, *konkretisht*:

4. z. P.L.

5. zj. E.M.

6. z. V.P.

a. Për prokurimin publik me objekt “Ndërrhyrje emergjente në banesat e komuniteti Egjiptian, Përmet”:

-Vlerësimi i KVO-së në përzgjedhjen e ofertës fituese është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreun V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim me devijime të vogla të pranueshme nga ligji, duke përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave, duke shkaktuar efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Përmet në vlerën 653,131 lekë.

b. Për prokurimin publik me objekt “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetin Egjiptian, Përmet”:

- Vlerësimi i KVO-së në përzgjedhjen e ofertës fituese është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreun V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim me devijime të vogla të pranueshme nga ligji, duke përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave, duke shkaktuar efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Përmet në vlerën 1,340,598 lekë.

c. Për prokurimin publik me objekt “Rikualifikim urban i Qendrës së Qytetit, fasadat, ndriçimi, lulishtja, Qyteti Përmet”:

- Vlerësimi i KVO-së në përzgjedhjen e ofertës fituese nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit, pasi ky OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK, duke vepruar në kundërshtim me nenin 46, 53 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KVO duhet të kishte skualifikuar OE “R...a” dhe ti kishte kërkuar AK anulimin e procedurës dhe përsëritjen e saj në zbatim të neneve 24/ç, 47 ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Shënim: Për punonjësit e larguar nga puna: **zj. F.H.** me detyrë Drejtore e Financës deri më 24.12.2014, **z. Ē.V.** me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të ardhurave për vitin 2013-2014, **z. D.L.** me detyrë inspektore e Taksave për vitin 2013-2014, **z. D.M.** me detyrë inspektore e Taksave për vitin 2013-2014, nuk rekomandohet masë disiplinore pasi kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin dhe nuk kanë adresim institucional.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Bashkia Përmet për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko-financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Bashkia Përmet, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Julian Adili, Irma Shkupi, Abdulla Duka, Rajmond Koçi, dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT